

RAPORT VJETOR

I.Përmbledhje Ekzekutive

II.Baza Ligjore

III.Organizimi

- Misioni i auditimit të brendshëm
- Organizimi i NjAB

IV.Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

- Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese
- Analiza e misioneve të auditimit
- Fushat me risk më të lartë dhe trajtimi i tyre
- Gjetjet kryesore sipas sistemeve
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

V.Rekomandimet

- Rekomandimet e propozuara
- Përgjigjia dhe reagimet e menaxhimit

VI.Monitorimi i Sistemit dhe Sigurimi i Cilësisë

VII.Analiza e Kapaciteteve Audituese

- Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB
- Kapacitetet audituese
- Zhvillimi i aftësive dhe ngritja e nivelit profesional të audituesve

VIII.Konkluzione

- Konkluzione mbi problematikën e punës audituese
- Prioritetet për vitin e ardhshëm

RAPORT VJETOR

I. Permbledhje Ekzekutive

Raporti Vjetor mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm të Buxhetit Gjyqësor, fokusohet në drejtimet e mëposhtme:

- *Së pari:* Komunikon rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm publik në gjykata dhe tregon qeverisjen dhe shërbimin publik në gjyqësor.

Raporti përçon problemet më të rëndësishme të identifikuara dhe të trajtuara, tregon ecurinë drejt përmirësimeve të vazhdueshme dhe veprimeve korrigjuese, si dhe sfidat e përpjekjet e pandërprera, për të siguruar pajtueshmërinë me kuadrin legjislativ të parashikuar në aktivitetin ekonomik e financiar të gjyqësorit.

- *Së dyti:* Ky raport paraqet përgjegjshmërinë e realizimit të programit të auditimit. Ai trajton menaxhimin e burimeve, treguesit dhe matësit e performancës, si dhe shkallën e pajtueshmërisë me standartet profesionale të auditimit. Në këtë këndvështrim, raporti është në pajtueshmëri me kërkesën për përgjegjshmëri dhe reformat që qeveria po kryhen në sektorin publik në Shqipëri dhe implementimi nga Bordi Drejtues i këtyre vendimeve.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, janë të pasqyruara në raportet e auditimit të dërguar çdo gjykate.

Raporti, përshkruan statusin, autoritetin, strukturën organizative dhe burimet e njësisë së auditimit, ai përvijon procesin e planifikimit mbi bazë risku si një risi të përdorur si fillim në vitin 2012 dhe e konsoliduar tashmë gjatë veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

II. Baza Ligjore

Strukturat e auditimit të brendshëm, përmbushin përgjegjshmëritë e tyre sikurse përcaktohen në Ligjin për Auditimin e Brendshëm, Manualin e Auditimit, Kartën dhe Kodin e Etikës për audituesit, nëpërmjet implementimit të Planit Vjetor, i cili përcakton qartë objektivat për t'u arritur, treguesit e matjes së performancës së auditimit, kapacitetet në dispozicion si dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut.

Kuadri ligjor dhe procedural i auditimit të brendshëm përfaqësohet nga:

- Ligji Nr.9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” me ndryshimet në Shtator të vitit 2010;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.640, datë 11.06.2009, “Për miratimin e Letër Politikave për KBFP dhe planit të veprimit, 2009-2014” të Brendshëm dhe të Kartës së Auditimit të Brendshëm Publik”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.806, datë 06.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së auditimit financiar”;
- Ligjin mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin publik;
- Tërë paketën ligjore të organizmit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor;
- Manualin e Auditimit të brendshëm publik dhe Manualin Specifik të Gjyqësorit;

RAPORT VJETOR

- Kuadrin e Praktikave Profesionale Ndërkombëtare, i cili përmban Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Praktikave Profesionale të publikuara nga IIA.

Dokumentet janë udhëzuesit kryesorë për krijimin dhe zhvillimin e një sistemi modern të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Shqipëri, si një nga kërkesat themelore për integrimin Evropian të Shqipërisë në Bashkimin Evropian

III. Organizimi

▪ Organizimi, përbërja dhe funksionimi i strukturave të auditimit.

Është krijuar Njësia e Auditimit të brendshëm, por struktura organizative, duhet të shtohet dhe me një audit tjetër, sipas kërkesave ligjore të reja për auditin për realizimin e kontrollit të cilësisë si detyrim ligjor. Numri i punonjësve është 3 auditë, i miratuar me vendim Bordi. Me gjithë përpjekjet tona për të shtuar dhe një audit, akoma nuk kemi arritur të forcojmë strukturën me burimet e nevojshme njerëzore, në fund të vitit 2013 dhe fillim të vitit 2014. Me ndryshimet e standarteve të auditit, me rritjen e numrit të objekteve për audit, kemi kërkuar shtesë për vitin 2015 dhe kemi edhe mbështetjen e organeve drejtuese.

Struktura e miratuar është si vijon:

- Drejtues i Njesisë 1
- Inspektor Audit 2

▪ Misioni

Njësia e auditimit të brendshëm kryen veprimtarinë e saj në zbatim të ligjit Nr.9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, me paketën ligjore e nënligjore të plotë dhe ushtron veprimtarinë e saj audituese brenda autoritetit, objektit dhe sipas përgjegjësisë e të drejtave të parashikuara në këtë ligj dhe kuadrin rregullator në fuqi.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm, ka si mision vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes së gjyqësorit dhe jep siguri të arsyeshme nëse:

- informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacionale, janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
- burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- asetet janë ruajtur;
- veprimtaritë e gjykatave janë në pajtueshmëri me politikën, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara.
- objektivat kryesorë të përcaktuara në programet dhe planet do të arrihen.

RAPORT VJETOR

Misioni ynë, është të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në pushtetit gjyqësor.

Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardt e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikrat e mira europiane.

Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike, në tërë gjykatat si konsumator të parasë publike.

Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksa paguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike gjyqësore.

IV. Rezultatet e veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

▪ Analiza e programeve të auditimit per periudhen raportuese


Në zbatim të kërkesave të nenit 7, të Ligjit Nr.9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ndryshuar me Ligjin Nr.10318, datë 16.09.2010 dhe të Kapitullit III, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, në Urdherin e Ministrit të Financave Nr 69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, Manualit specifik të auditimit, auditimi i ushtruar ka synuar të përfshijë ato subjekte të saj, të cilat lidhen me misionin dhe qëllimin për të cilin ajo funksionon.

Bazuar në piken 1.5.2, të Kapitullit I të Manualit, veprimtaria audituese është orientuar në: auditimin e sistemeve dhe vlerësimin në thellësi të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, të vendosura nga niveli i menaxhimit të Bordit Drejtues dhe Kryetarët e Gjykatave, me qëllim përcaktimin nëse ato funksionojne me kosto efektive, në mënyrë efëçente dhe për arritjen e objektivave të gjyqësorit në fushën e administrimit publik ekonomik.

Në zbatim të kërkesave të nenit 7, të Ligjit Nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ndryshuar me Ligjin Nr.10318, datë 16.09.2010 dhe të Kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdherin e Ministrit të Financave Nr 69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, auditimi i ushtruar ka synuar të përfshijë ato subjekte të saj të auditimit, të cilat lidhen me misionin dhe qëllimin për të cilin ai funksionon. Bazuar në planin vjetor, kemi parashikuar 15 auditime, parshikuar këtë numer, pasi menduam se do shtonim strukturën dhe me nje audit.

Planifikimi dhe realizimi i programit të auditimit për vitin 2014, paraqitet:

RAPORT VJETOR



Nga 15 auditime të planifikuara, kemi realizuar 13 auditime, me një realizim në masën 94%. Mbetën pa u audituar, Gjykata e Rrethit Lushnje dhe Dibër. Janë në proces dy gjykata, përkatësisht Gjykata e Apelit Korçe dhe Gjykata e Rrethit Pogradec dhe gjetjet e tyre nuk i kemi raportuar në pasqyrat përkatëse. Mosrealizimi ka ardhur si rezultat i zbatimit të standarteve të reja të auditit, mungësës së strukturës me një audit, por edhe i punës së sforcuar të strukturës.

Nga përlogaritjet e ngarkesës për çdo auditim, kanë rezultuar mesatarisht për rreth 7 objekte të audituara mbi bazë sistemi. Drejtuesi i Njësisë, ka realizuar edhe punën e auditit.

Bazuar në pikën 1.5.2 të Kapitullit I të Manualit, veprimtaria audituese është orientuar në: auditimin e sistemeve dhe vlerësimin në thellësi të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, të vendosura nga niveli i menaxhimit, Bordi Drejtues, Drejtori i Zyrës dhe Kryetarët e Gjykatave. Auditimi ka si qëllim përcaktimin nëse ato funksionojnë me kosto efektive, në mënyrë efikente, me qëllim arritjen e objektivave të gjyqësorit në fushën e administrimit publik dhe ekonomik. Është kryer angazhim për problemin e avokatëve jashtë planit vjetor, me vendim të Bordit Drejtues.

Auditimet e plota kundrejt auditimeve tematike.

Shmangiet nga plani vjetor, janë reflektuar dhe në shmangien e realizimit sipas llojeve, të auditimeve të kryera në raport me llojet e parashikuara. Sipas parashikimeve, në Planin Vjetor 2014 llojet e auditimeve të parashikuara, klasifikohen si vijon:

AUDITIME SIPAS LLOJIT, TË PLANIFIKUARA, TË REALIZUARA

Auditime të Plota 13
Auditime Tematike 5

-Janë realizuar 13 auditime të plota me bazë sistemi. Kanë përfunduar dhe me dërgim raportesh final e memo përfundimi auditit.

RAPORT VJETOR

-Jane në proces 2 auditime, përkatësisht Gjykata e Apelit Korçë dhe Gjykata e rrethit Pogradec.

-Mbeten te pa audituara 2 gjykata, përkatësisht Gjykata e Rrethit Lushnje dhe Gjykata e Rrethit Dibër.

-Janë realizuar 7 auditime tematike të paplanifikuara, por të dala si nevojë gjatë vitit.

Mosrealizimi i dy auditimeve edhe pse drejtuesi i NJAB ka marrë pjesë në auditime, rezulton nga mungesa e burimeve njerëzore në NJAB.

▪ Analiza e misioneve të auditimit

Në zbatim të ligjit Nr.8363, datë 1.7.1998 “Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”, neni 9 i ligjit Nr.9720 datë 23.4.2007 “Mbi Auditin e Brendshëm Publik” Auditimi i Zyrës ka realizuar auditimin në baze të programit vjetor të auditit të miratuar në Bord për vitin 2014.

Në zbatim të pikës 5 të nenit 18, ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar me ligjin Nr.10318, datë 16.09.2010 dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm Publik të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr 69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, Seksioni IV, pika 4.7 e tij “Raportet periodike dhe raporti vjetor i AB”, Njësia e Auditimit të Brendshëm, ka përgatitur dhe ju paraqet Raportin periodik, për vitin 2014. Në mënyrë të përmbledhur rezultatet e saj paraqiten sa më poshtë vijon:

▪ Fushat me risk më të lartë dhe trajtimi i tyre

Në Planet Strategjike dhe Vjetore të Auditimit të Brendshëm, janë identifikuar dhe vlerësuar, risqet kryesore për veprimtarinë e gjykatave. Për vitin 2014, kemi bërë vlerësimin e riskut me tregues, për çdo gjykatë dhe vlerësojmë pushtetin gjyqësor me një performancë pozitive dhe me risk të mesëm, me tendencë drejt rrishtit të ulët, që është një arritje domethënëse e Zyrës dhe gjykatave si pushtet.

Në Ligjin “Për Auditimin e Brendshëm dhe Manualin e Procedurave”, janë përcaktuar dhe metodologjitë që përdoren për vlerësimin e riskut dhe pikërisht bazuar në këtë sistem të vlerësimit të riskut, njësia e auditimit ka programe, ku do të programojë dhe auditimin e fushave dhe subjekteve që paraqiten me një nivel të lartë risku. Nga analiza e raporteve vjetore individuale si dhe nga intervistat e realizuara, rezulton se përcaktimi i nivelit të riskut, është bërë duke marrë në konsideratë faktorët e riskut, të cilët në mënyrë të përmbledhur do të përgjithësoheshin në kategoritë e mëposhtme:

- Sasia dhe përdorimi i burimeve në dispozicion të gjykatës të audituar;
- Zbatimi i ligjshmërisë, politikave, procedurave, rregulloreve e planeve;
- Arritja e objektivave dhe rezultateve të pritshme;
- Ruajtja dhe miradministrimi i aseteve pronë publike;
- Funkcionet kryesore, organizimi dhe kompleksiteti i gjykatës që auditohet;

RAPORT VJETOR

- Kërkesat e raportimit financiar;
- Mjedisi i kontrollit në gjykata;
- Shkalla e ndryshimeve organizative dhe në drejtim;
- Mbulimi i pamjaftueshëm me auditime në të kaluarën

Duke u bazuar në përcaktimin e fushave me risk më të lartë, sa më sipër, struktura audituese ka vendosur dhe prioritetet e saj. Kështu, në subjektet apo fushat me risk më të lartë, janë angazhuar të gjitha burimet e auditimit me kohë të gjatë auditimi, që do të thotë që në këto auditime janë përfshirë staf më nivel të lartë profesional dhe është siguruar kohë e mjaftueshme për vlerësimin e subjekteve. Në auditime me risk, ka marrë pjesë vetë drejtuesi i strukturës.

Megjithatë, si rezultat i rivlerësimit të riskut gjatë vitit dhe kur menaxhimin e ka gjykuar të arsyeshëm, për fusha të cilat risku në situata të veçanta paraqitet më i lartë se vlerësimi në Planin Vjetor, do të kryen dhe misione auditimi me urdhër të vecantë. Atje ku risku është vlerësuar i një niveli të lartë, vëmendje e madhe i është kushtuar procesit të ndjekjes së rekomandimeve, duke synuar jo vetëm përcaktimin e efekteve të shkaktuara apo përgjegjësi, por mbi të gjitha, përmirësimin, parandalimin dhe përsëritjen e fenomeneve të tilla në të ardhmen. Bazuar në faktorët e përmendur më sipër, vlerësojnë me risk më të lartë fushat në vijim:

1• Sistemet e menaxhimit financiar. Pjesa më e madhe e të audituarve gjykojnë se pikërisht menaxhimi financiar është fusha ku risku është më i pranishëm. Po t'i referohemi analizës në seksionin “Gjetjet më të rëndësishme” të këtij raporti, janë pikërisht fushat e: prokurimeve publike, pagave, transaksioneve financiare, mbledhjes së të ardhurave dhe taksat, në të cilat janë zbuluar dhe shkeljet më të rëndësishme. Aplikimi i standarteve të reja është me risk.

2• Gjykatat, që qarkullojnë shuma të konsiderueshme të fondeve publike, të cilat sigurohen nga një numër i madh burimesh financimi, ku përfshihen dhe të ardhurat.

3• Investimet në Godina të Reja, ku përfshihet jo vetëm zbatueshmëria e kuadrit ligjor, por edhe shkalla e cilësia e implementimit të kontratave. Këto fusha, shfaqen jo vetëm me risk të lartë financiar, por dhe operacional, që ka të bëjë me cilësinë e punimeve, pagesat jo në konformitet me gjëndjen aktuale të punimeve, mbikqyrjen dhe marrjen në dorëzim të objekteve dhe garcinë e standartit të punimeve.

4• Gjykatat, apo fushat me dobësi të theksuara në sistemin e kontrollit të brendshëm, të cilat shfaqen me mangësi në kuadrin rregullator e procedural brenda vetë subjektit publik. Kjo ka të bëjë me gjykata, të cilat kanë pësuar ndryshime strukturore dhe nuk e kanë plotësuar akoma bazën rregullatore dhe funksionale të tyre, si dhe mungesa e burimeve njerëzore dhe e rregulloreve të brendshme.

5• Menaxhimi i burimeve njerëzore. Qarkullimi i shpeshtë i stafit dhe niveli i ulët profesional i punonjësve, ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave dhe cilësinë e punës.

RAPORT VJETOR

6• Gjykata me nivel të ulët të njohurive dhe përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit. Njohuritë e pamjaftueshme për këto sisteme, bëjnë që subjektet të ekspozohen në një shkallë të lartë të riskut, pasi nuk mund të përshtaten dhe të përdorin sisteme të tilla, që shpesh janë dhe të detyrueshme (psh. sistemi i ORAKULL për Degët e Thesarit në rrethe, sistemi i përgatitjes së PBA-së, apo prokurimet publike). Ka gjykata, që përpunojnë informacionet e tyre në mënyrë manuale, ku risku i gabimeve në llogaritje apo të dhëna shfaqet i lartë.

▪ Gjetjet kryesore sipas sistemeve.

Gjate procesit të auditimit të brendshëm, menaxhimi është informuar mbi gjetjet e auditimit. Raportimi i gjetjeve të punës tek menaxhimi i Gjykatave dhe lënia e rekomandimeve për të përmirësuar funksionimin e gjykatave, është një nga pjesët më të rëndësishme të procesit të auditimit të brendshëm.


Për periudhën raportuese, gjetjet e evidentuara dhe të paraqitura në pasqyrat përkatëse, paraqesin zbulimet dhe evidentimet, të raportuara nga auditimet e kryera për vitin 2013. Nga gjykatat kemi patur reagime pozitive në lidhje me zbatimin e rekomandimeve. Pas dërgimit të raportit final në cdo gjykatë, kemi informuar titullarin mbi përfundimin e cdo misioni auditues.

Gjatë procesit të auditimit të brendshëm, menaxhimi është informuar mbi gjetjet e auditimit. Raportimi i gjetjeve të punës tek menaxhimi i Gjykatave dhe lënia e rekomandimeve për të përmirësuar funksionimin e gjykatave, është një nga pjesët më të rëndësishme të procesit të auditimit të brendshëm. Për periudhën raportuese, gjetjet e evidentuara dhe të paraqitura në pasqyrat përkatëse, paraqesin zbulimet dhe evidentimet e raportuara nga auditimet e kryera gjatë vitit 2014. Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, pranë gjykatave të audituara, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, për vitin 2014, janë dhënë gjithsej **184** rekomandime për përmirësimin e sistemeve si vijon:

- 1.Sistemin organizativ 36.**
- 2.Sistemin i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit 17.**
- 3.Sistemin i prokurimit, blerjet e vogla dhe zbatim kontratash 48.**
- 4.Sistemin e pagave dhe pagesave 34.**
- 5.Sistemin e kontabilitetit dhe raportimit publik 39.**
- 6.Teknologjinë e informacionit 10.**

Grafikisht paraqiten :

RAPORT VJETOR




Me konkretisht: Vlera e përgjithshme e gjetjeve për shkeljet financiare nga angazhimet e auditimeve për vitin 2014, rezulton në shumën 7 898 mijë lekë, nga e cila 2 549.6 mijë lekë, dëm ekonomik.

Te ndara sipas sistemeve/fushave, këto gjetje rezultojnë përkatesisht si më poshtë:


- Në sistemin e pagave dhe pagesave, në shumën 2 549.6 mijë lekë, që përbën vlerën e dëmit ekonomik.
- Në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit publik 5348.4 mijë lekë, e cila përbehet nga:
 - 66 .5 mijë lekë vlerë (*Gjykata Berat*), që i kalon buxhetit të shtetit si e ardhur, pasi janë detyrime ndaj të tretëve (*eksperteve*), që kanë kaluar afatin e parashkrimit;
 - 1967.4 mijë lekë, janë vlera e projekteve të rikostruksionit, të pasqyruara në pasqyrat financiare në poste të gabuara (*Gjykatat e Apelit Tiranë dhe Gjyrokastër*);
 - 3314 mijë lekë, amortizim i llogaritur më tepër se vlera fillestare e aktivitetit (*Gjykata e Apelit Gjyrokastër*)

Në mënyrë grafike, paraqiten si më poshtë:

RAPORT VJETOR



Krahasimi i vlerës së dëmit ekonomik për vitet 2013 & 2014 rezulton:




Vlera e gjetjeve me dëm ekonomik, në krahasim me vitin 2013, është ulur, si rrjedhojë e rritjes së nivelit të punës menaxhuese në gjykata, por edhe lënies së rekomandimeve efikase dhe zbatimit të tyre.

Të gjitha këto rekomandime, janë dhënë në bashkëpunim me Kryetarët e Gjykatave dhe struktura e auditimit ka patur mirëkuptim për rekomandimet e dhëna. **Për të gjitha auditimet e vitit 2014, është njoftuar Kryetari i Bordit Drejtues dhe Nëpunësi Autorizues për përfundimin e misioneve.** Rekomandimet e dhëna, kanë qenë kryesisht të karakterit ligjor, organizativ dhe për zhdëmtim. Në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare, kemi patur si synim uljen në maksimum të mundësisë së përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.

Krahasimi i rekomandimeve të dhëna dhe të pranuar në vitet 2013-2014 paraqitet si vijon:

RAPORT VJETOR



Për vitin 2013, janë dhënë gjithsej 118 rekomandime dhe për vitin 2014, janë dhënë 184 rekomandime. Nga shqyrtimi i të dhënave si më sipër, rezulton se në sistemet organizative dhe ato të buxhetit, për vitin 2014, kemi ulje të rekomandimeve, që vjen si rrjedhojë e përmirësimit të punës së gjykatave, pasi në të gjitha gjykatat e audituara, ka përfunduar hartimi i rregulloreve të brendshme, janë krijuar GMS, janë hartuar rregjistrat e riskut, si dhe janë hartuar PBA.

Me rritje rezultojne sistemet e pagesave, prokurimit dhe raportimit publik, në të cilat janë konstatuar mangësi kryesisht në pagesat e avokatëve të thirrur kryesisht, ekspertëve, psikologëve, orët jashtë orarit, shtesa mbi pagë, dieta etj., që vjen si pasojë e disa problemeve që ka legjislacioni ekzistues (*avokatë, ekspertë, psikologë*), moskuptimit dhe moszbatimit të drejtë të legjislacionit nga ana e punonjësve që meren me zbatimin e tij, mungesës së kualifikimit dhe trajnimeve të këtyre punonjësve, si dhe mungesës së profesionalitetit në disa raste.

Auditimi i sistemit IT është shtuar në auditimet e këtij viti.

REKOMANDIME SIPAS SISTEMEVE.

▪ Sistemi organizativ

1. Në gjykatat e rretheve Durrës, Berat, Gjirokastrë dhe Korçë, çënohet siguria dhe funksionimi normal i aktivitetit të tyre pasi:

- Nuk është zgjidhur nga ana funksionale mënyra e marrëdhënieve me publikun;

RAPORT VJETOR

- Në gjykatat Durrës, Korçë dhe Gjirokastrë, vendosja në të njejtën godinë edhe të gjykatave Administrative;
- Ekzistenca e Zyrave të Përmbartimit brenda ambienteve të këtyre gjykatave;

- 2. Marrja në kontabilitet e godinës së Gj.K.Rënda**, e cila kërkon bashkëpunim të ZABGJ dhe Bordit me Min.Drejtnësisë.
- 3. Strukturat organike për administratën mbështetëse në disa gjykata si, Gjkata e Apelit Tiranë, Gjkata e Rrethit Durrës, Gjkata e Rrethit Korçë (të audituara për periudhën) etj.**, me numër të madh çështjesh dhe punonjësisish, janë të pa përshtashme dhe kanë rritur ngarkesën për disa pozicione pune, si dhe nga ana funksionale, bien në kundërshtim me ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në NJSP”. Strukturat organike duhet të hartohen duke marrë në konsideratë aktivitetin e cdo gjykate, duke bashkëpunuar edhe me kryetarët e gjykatave.
- 4. Duke patur parasysh, që në gjykata janë instaluar kaldaja për sistemin e ngrohjes, duhet të parashikohen në strukturat organike, punonjës specialistë për mirëmbajtjen dhe funksionimin e tyre, pasi janë mjete nën presion, të cilat përbëjnë dhe rrisht në funksionimin e gjykatave. Mendojmë që një zgjidhje më racionale se kaldajat, mund të japë zgjidhje me racionale ngrohjes dhe ftohjes me gjykata, pasi gjykatat që i kanë, po hasin në probleme të ekonomicitetit, eficensës dhe efikasitetit.**
- 5. Arkivat e ish gjykatave Skrapar, Tepelenë, Mirditë, (të audituara për periudhën) etj.**, kërkojnë parashikimin e fondeve për mirëmbajtje dhe sigurinë fizike ose transferimin e dokumentacioneve pranë gjykatave, të cilat i kanë në administrim. Transferimi i dokumentacionit pranë ambienteve të gjykatave respektive, do të rezultojë si zgjidhje më racionale.
- 6. Vendosja e dedektorit të armeve në Gjykatën Berat dhe rinovimi i sistemit të MKZ-ve në gjykata në tërësi.**
- 7. Duhet të përfundojë procesi i hartimit dhe miratimit të Rregulloreve të Brendshme për cdo gjykatë, ku të gjejnë pasqyrim përgjegjësitë e cdo hallke të menaxhimit dhe administrimit publik në sistemin gjyqësor, sipas detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr.10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të përcaktohet protokollin i ruajtjes e mbrojtjes së informacionit të perdoruesve në gjykata, si dhe kontrollin periodik i pajisjeve, nga IT-ja, por të jetë katalizator në harmonizimin e një rregullimi të plotë dhe të qëndrueshëm në këtë sistem.**
- 8. Të hartohet rregjistri i riskut dhe ai duhet të jetë sipas përcaktimeve të kreut III “Identifikimi i risqeve” të “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” në të gjitha gjykatat.**
- 9. Rekomandim mbi përmirësimin e unifikimit të praktikës së pagesës së gjyqetarëve (Udhëzimit të Bordit), për trajtimin dhe kompesimin mbi kohën normale të punës.**

RAPORT VJETOR

Auditi shpreh opinionin, që pagesa duhet bërë vetem atëherë kur gjyqtarët bëjnë punë materiale (japin vendime gjyqësore), si dhe rishikimit të vendimit, pasi ka kosto financiare në buxhetin e shtetit.

10. Nevojitet të ketë një rregullore unike mbi funksionimin e gjykatave, si dhe përcaktimin e standarteve të emërimit të administratës gjyqësore, të qarta ligjore.
11. Problemi i organikave, duhet të zgjidhet me ndërhyrjen e Zyrës (Bordit), pasi edhe në ligjin organik, që ka sot Ministria e Drejtësisë, ajo nuk ka shkruar në menyrë të qartë autoritetin e saj mbi miratimin, shtesat apo pakësimet e organikave në gjykata.

Rekomandojmë, që një marrëveshje ose memorandum midis Zyrës, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, do të zgjidhte përfundimisht problemin e ngërçit të organikave në shumë gjykata, si dhe do të rriste rolin që ka Bordi ligjërish, mbi financat e gjyqësorit. Meqënëse, Zyra miraton fondet, ajo duhet të ketë dhe autoritetin për të komunikuar me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë, për organikat.

▪ Sistemin i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit

1. Planifikim më i saktë nga ana e gjykatave, i shpenzimeve operative dhe monitorimi i realizimit të tyre, pasi në disa gjykata, rezultojnë detyrime në fund të vitit, ndaj furnitorëve për blerje dhe shërbime, që kanë tejkaluar fondet e vitit ushtrimor.
2. Shërbimet gjyqësore të cilat gjenerojnë të ardhura dytësore, kryesisht në objektin e padive, janë të natyrave të ndryshme, si të tilla kërkojnë një rishikim dhe detajim të emërimit dhe të tarifës përkatëse. Udhëzimi i ri, duhet të përfshijë edhe procesin penal, për pjesën e të ardhurave që duhet të realizohen nga ekzekutimin i dispozitivit të gjyqeve penale (shpenzimet penale që kryhen nga ana e shtetit).

Situata e padive civile, që janë adresuar në gjykatën e Tiranës dhe gjykata të tjera, rezulton që e kalon numrin e 200 lloje padish civile me perafërsi. Për rrjedhojë, kërkohet një Udhëzim unik për tarifën e shërbimit gjyqësor, i standartizuar, të jetë sipas strukturës së padive civile, me qëllim që të kontribuojë si në të hyrat publike, por dhe në rritjen e mirëqenien financiare të pushtetit gjyqësor. Udhëzime të tilla, kanë si vendet fqinje edhe ato të Komunitetit Europian.

Mendoj, se Udhëzimi duhet të jetë i plotë, si në formë, edhe në përmbajtje, ku duhet të percaktojë qartë si vijon:

- Qëllimin, entet ku aplikohet dhe palët në proces;
- Përcaktimi i taksës kur bëhet, ku bëhet, për proceset civile dhe autoriteti përgjegjës;
- Mënyra e pagesës, limitet e pagesës kesh dhe në bankë;
- Si duhet të raportojnë gjykatat për të hyrat e gjyqësorit;
- Mbledhja e taksës;
- Lirimi nga pagesa e taksave gjyqësore;

RAPORT VJETOR

- Publikimi i tarifave;
- Në rast mospagimi takse, kush mban përgjegjësi;
- Po kur dosja është në gjykim në nivele më të larta, kush duhet të kerkoj arkëtimin e taksës?;
- Në rast se vendimi ka marrë formë të prerë, çfarë do të ndodhë me tarifën që mund të rezultojë e papaguar?;

Duhet te krijojme shkallë të tarifave sipas shumave të kerkuara, duke vendosur një kufi nga 100000 lekë deri në kufirin 50000000 lekë, duke vendosur dhe nje kufi limit pagesë për tarifë shërbimi dhe e shkallëzuar atë. Vende e fqinje si Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia, kanë një strukturë tarife shërbimi në gjyqësor me mbi 220 lloj tarifash dhe kamë të ardhura dhjetra herë më të larta se gjyqësori ynë. Për këtë, kërkohet bashkëpunim ndërmjet Zyrës, Bordit, M.Drejtësisë dhe M.Financave, për përcaktimin e tarifave të shërbimit si dhe të percaktohet një nivel më i lartë perfitimi për gjykatat, i cili të ketë si destinacion *investimet dhe mirëmbajtjen e godinave*.

▪ Sistemin i prokurimit, blerjet e vogla dhe zbatim kontratash

1. Në lidhje me prokurimet, konstatohen mangësi në njohje dhe në zbatim të këtij legjislacioni, që ka të bëjë me:

- Në disa gjykata, nuk zbatohet e plotë *Gjurma e Auditit*, sipas Urdhërit Nr. 33, datë 11.07.2013, të Ministrisë së Financave “Për gjurmën standarte të auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë”.
- Percaktimin dhe miratimin e fondit limit në zbatim të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
- Kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të materialeve e paisjeve nga operatorët ekonomik, sipas kërkesave të Udhëzimit të Bordit, **Nr. 3 datë 7.5.2012** “Për procedurat e ruajtjes, mbrojtjes dhe kriteret e kompetencat për nxjerrjen nga Përdorimi të aktiveve nga përdorimi në njësitë e gjyqësorit”, kap.III-1.
- Arshivimit të dosjeve të prokurimeve me vlera të larta.

Këto mangësi, kërkojnë trajnime periodike të punonjësve të cilët merren me prokurimet publike, të cilat mund të kryhen në grup, në bashkëpunim te Zyres me Kryetarët e gjykatave.

2. Problemet në Informatizimin e sistemit dhe i mobilimit.

Cdo vit investohen me miliona lekë në gjykata për Teknologji informacioni dhe mobilime. Këto prokurime, kryhen nga gjykatat, duke mbartur risk dhe herë pas here, blihen produkte jo të mira, pa stadartë teknike dhe konformitet, dhe për më tepër, me cmime të ndryshme. Mendoj, që të bëhet një analizë e gjendjes së tyre, pasi janë krijuar mallra stoqe. Në mënyrë që të plotësojmë nevojat me paisje sipas standarteve, blerjet të bëhen të përqëndruara.

RAPORT VJETOR

▪ Sistemin e pagave dhe pagesave

1. Për punën e kryer jashtë kohës normale të punës dhe punën e kryer në ditë pushimi e festash zyrtare, VKM Nr.463 datë, 16.6.2011, si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 20/07/2011, “Mbi zbatimin e vendimit Nr.463 nga ana e gjykatave”, nuk interpretohet dhe zbatohet sipas një standarti.

Problemet në lidhje me zbatimin e VKM Nr.463 janë:

- Në disa gjykata, pagesa e gjyqtarëve të gatshëm sipas grafikut, bëhet për të gjithë ditët e gatishmërisë, në disa të tjera, vetëm kur gjykohen çështje.
- Sekretaret gjyqësore, në disa gjykata, përfshihen në grafikun e shërbimit, në disa të tjera, nuk përfshihen.
- Sekretaret gjyqësore, në shumicën e gjykatave, janë paguar për orët shtesë kur janë gjykuar çështje, ndërsa në një gjykatë, janë kompesuar me pushim, ndërkohë që udhëzimi Nr.16, datë 20/07/2011, përcakton kompesim me pushim të orëve jo operacionale.
- Administrata mbështetëse, në disa gjykata është paguar, ndërkohë që Udhëzimi nr.16, e ka përcaktuar në mënyrë taksative kompesimin me pushim citoj: ***Në asnjë rast, punonjësi i administratës publike, që kryen veprimtari administrative, nuk kompesohet financiarisht për kohën e punuar mbi kohën normale të punës, por kompesohet vetëm me orë/ditë pushimi.***
- Nuk zbatohet e plotë procedura, si ajo para kryerjes së punës, gjatë kryerjes së punës dhe në përfundim të punës.

Për sa më sipër, nga ana e Zyrës, Udhëzimi i nxjerrë në zbatim të VKM Nr.463 dhe Udhëzimit Nr.16, të M.Financave, duhet të përmirësohet, duke qartësuar këto problematika. Njëkohësisht, në rastin e sekretareve gjyqësore, të shihet mundësia e shfrytëzimit të pikës 4, paragrafi i fundit i Udhëzimit nr.16, ***citoj: “në raste specifike, merret miratimi, i Ministrisë të Financave”*** pra, duke marrë një miratim të tillë.

2. Pagesa e avokatëve të caktuar kryesisht, në zbatim të Urdhërit Nr.1284/3, datë 16.3.2005, të Ministrisë të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, ka paqartësi në zbatim, pasi ka kufizim në përcaktimin e objektit të përfaqësimit dhe të masës së pagesës, njëkohësisht, nuk ka të përcaktuar se pagesa do të kryhet për një, apo disa seanca përfaqësimi.

Në disa gjykata, konstatohet se trupa gjyqësore, është shprehur për masën e pagesës së avokatit kryesisht, me vlera më të larta se Urdhëri Nr.1284/3. Njëkohësisht, konstatohet se për pagesën e avokatëve kryesisht, si dokument justifikues, përdoret fotokopje e vendimit të gjykatës, që mund të jetë deri edhe 7-8 faqe, gjë që është pa kuptim, por ka dhe kosto financiare. Po kështu, në shumicën e rasteve të pagesave të avokatëve kryesisht, konstatohet fenomeni i paraqitjes së faturës nga avokatët pas 1 deri në 2 vjet me vonesë (*nuk ka lidhje me përfundimin e gjykimit*), veprim i cili bie në kundërshtim me ligjin për kontabilitetin dhe udhëzimet për zbatimin e buxhetit.

RAPORT VJETOR

Rekomandimi i auditit për pagesën e avokatëve kryesisht është, që Zyra, në bashkëpunim me Bordin, të kërkojnë përmirësimin e Urdherit Nr.1284/3, si dhe të miratohet në Bord një Urdhër ose Udhëzim, në zbatim të tij, ku të qartësohen:

- Masa e pagesës së avokateve kryesisht (p.sh per një seancë, ose deri në përfundim të gjykimit, grup ceshtje, etj);
 - Hartimi i një formati standart, si dokument justifikues pagese, që i bashkëlidhet faturës tatimore të leshuar nga avokati, me ekstremitetet më të domosdoshme dhe të konfirmohet nga gjyqtari i çështjes;
 - Përcaktimi i afateve maksimale të paraqitjes së faturës nga ana e avokatëve në degët e buxhetit të gjykatave;
 - Mos aplikimi i masës së pagesës së avokatit në vendimin e gjykatës;
 - Ndarja e kufirit me Komisionin e Ndihmës Juridike.
3. Në gjykata, konstatohet, sidomos për të miturit, marrja e psikologëve, për të cilët nuk ka një vendim, udhëzim apo urdhër për masën e pagesës. Edhe për këtë problem, auditu rekomandon, që Zyra dhe Bordi, të kërkojnë nga ana e M.Drejtësisë, nxjerrjen e një Udhëzimi për pagesën e tyre.
4. Në disa gjykata, konstatohet se në ceshtjet civile, ku kërkohet ekspert, të cilët paguhet nga palët, vlera e pagesës së ekspertit, arkëtohet fillimisht në arkat e gjykatave dhe në përfundim të aktit të ekspertimit, fatura e ekspertit paraqitet pranë gjykatës dhe paguhet nga ata të cilët mbajnë dhe tatimin në burim, por ky veprim nuk pasqyrohet në librat e kontabilitetit, pasi është veprim që kryhet ekstrakontabel dhe nuk është detyrim i gjykatës apo i degëve të buxhetit në gjykata, por i palëve në gjykim. Deget e buxhetit, i arkëtojnë me arsyetimin së e kërkojnë gjyqtarët dhe nuk vazhdojnë gjykimin e çështjeve, në rast se nuk konfirmohet arkëtimi në arkën e gjykatës. Ky veprim, bie në kundërshtim me ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në NJSP”. Për këtë, auditu rekomandon, që nga ana e Zyrës të dërgohet një Sqaruese apo qarkore, ku të qartësohet se, pagesa e ekspertëve nga palët, të kryhet nëpërmjet derdhjes në llogarinë bankare të ekspertit dhe në seancën e radhës, të kërkohet dhe të jetë pjesë e dosjes M.Arkëtimi i Bankës.

5.Sektori i ruajtjes se godinave.

Me nenin 41 te ligjit të Pushtetit Gjyqësor, autoriteti i ruajtjes së godinave, është Policia e Shtetit. Në dy vite, rreth 13 % e parave të gjyqësorit, janë përdorur për ruajtje godinash nga policia private nga shpenzimet koherrente. Këto shpenzime i kanë vënë të gjitha gjykata në vështirësi financiare. Marja e godinave nga Policia e Shtetit, do të sigurojë më shumë hapësira për funksionimin e gjykatave dhe mundësi për investime, si dhe do të krijojë mundësi për rreth 50 milion lekë të reja më shumë për gjyqësorin.

▪ Sistemin e kontabilitetit dhe raportimit publik

RAPORT VJETOR

1. Në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare në përgjithësi, është zbatuar drejt VKM Nr.248, datë, 10/04/1998, si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr.26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore”, i ndryshuar, por janë konstatuar edhe disa mangësi të karakterit teknik, të cilat i paraqesim më poshtë:

- Në disa gjykata, zbatohet parimi i kontabilitetit të *arketimit dhe pagesave*, në disa, parimi i të *drejtave dhe detyrimeve të konstatuara* (parim mbi të cilin duhet të mbahen percaktuar në VKM Nr.248 është parimi i të drejtave të konstatuara);
- Në disa gjykata, regjistrimet kontabile kryhen në libra, në disa të tjera mbahen në kompjutera, kryesisht në Excel.
- Disa veprime kontabile nuk pasqyrohen drejt në postet perkatëse në Bilance, kryesisht llogaritë e furnitorëve (401-408), të cilat pasqyrohen në Llogarinë 468 ose 467, pasqyrimin e të ardhurave, kryesisht në pasqyrat shoqeruese të bilancit, raportojnë vlerat totale nga shitja e pullave të taksës dhe vlerën e tarifave nga shërbimet, ndërkohë që duhet të pasqyrojnë si të ardhur, pjesën që u takon sipas përqindjes. Në asnjë rast, nuk ka regjistrime në ditar të ardhurash, të pjesës së të ardhurave, që u takon sipas derdhjeve, që bëhen në thesar nga arkëtimet nga aktiviteti dytësor ose si agjent për pullat e taksës, të cilat duhet të rakordojnë me llogarinë 476 (pjesa nga të ardhurat) që kontabilizohet mbi bazën e celjeve nga thesari dhe rakordimeve me to;
- Detyrime (shpenzime), që i takojnë një viti ushtrimor, nuk pasqyrohen fare në bilancet e këtij viti, por si shpenzime të vitit pasardhës (*shkelet parimi i të drejtave të konstatuara*);
- Në disa raste, vlerat e projekteve të rikostruksionit apo ndërtimeve të reja, edhe pas marrjes në dorëzim të objekteve, nuk i shtohet vlerës së ndertesës, por pasqyrohet në postin e projekteve (llog 202);
- Llogaritja e amortizimit të AQT-ve, në dy raste ka kaluar vlerën fillestare, gjë që tregon se amortizimi kryhet edhe ekstrakontabel.

Per sa parashtuam më sipër, del si konkluzion, se punonjësit e degëve të buxheteve, duhet të trajnohen periodikisht. Rekomandimi i auditit në lidhje me kontabilitetin dhe raportimin publik, konsiston në standartizim të tij, nëpërmjet përdorimit të softuerve informatik si dhe trajnimin e punonjesve. Informatizimi do të krijojë lehtësim të ngarkesës së punonjësve të degëve të buxhetit, menaxhim më të mirë të fondeve publike, monitorim edhe nga ZABGJ të përdorimit të fondeve në kohe dhe në menyrë të shpejtë, si dhe përpunim dhe informacion të shpejtë dhe të saktë të të dhënave.

2. Viti 2015, të konsiderohet si vit i pastrimit të llogarive nga stoqet dhe asetet inaktive, të cilat janë kosto e panevojshme për gjyqësorin, sidomos mjetet e transportit, ku mbi 60% e tyre janë jo efektive.

Në drejtim të Kontabilitetit, Pasqyrave Financiare dhe raporteve vjetore, konstatohet mungesa e sistemit të plotë të raportimit financiar publik, si dhe një dobësi e nivelit profesional të kryetarëve të degëve të buxhetit në disa gjykata, ku inventarizimet e pasurisë, nuk trajtohen si procese teknike dhe ligjore të administrimit të pronës. Kërkohet trajnim në lidhje me këtë proces. Për unifikimin, rritjen e efektivitetit dhe performancës së sistemit

RAPORT VJETOR

kontabël dhe Pasqyrave Financiare, duhet të kalohet në mbajtjen e kontabilitetit nëpërmjet softuereve, si dhe kryerjen e një studimi për këtë proces.

▪ **Teknologjinë e informacionit**

- Hartimi i rregulloreve të brendshme në cdo gjykatë, për funksionimin e IT dhe përcaktimin e rregullave dhe procedurave të qarta për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave;
- Marrja e masave për ruajtjen dhe sigurinë e serverave.

▪ **vlerësimi i sistemeve të kontrollit brendshëm**

Në ushtrimin e funksionit të tyre, strukturat e auditimit, kanë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike. Sistemet e kontrollit në gjykata, janë efektive dhe funksionojne.

V. Rekomandimet e auditimit

1 Përcaktimi i përgjegjësi, propozimet për rekomandime.

Krahas problematikës së ngritur në seksionin e mësipërm, vihet re se për gjetjet e konstatuara nga strukturat audituese, ***është përcaktuar plotësisht përgjegjësia***. Ky fakt, konsiderohet si një tregues pozitiv i performancës së auditimit të brendshëm dhe tregon se rezultatet e punës janë shtrirë përtej konstatimit të gjetjeve.

Në bazë të manualit të ri, janë kryetarët e gjykatave, që japin masa mbi bazën e gjetjeve të auditimit. Është përgjegjësi e kryetarëve, të reagojnë mbi bazën e raportit final të auditit. Përcaktimi i përgjegjësi, ka sjellë efekt pozitiv edhe në dhënien e propozimeve për uljen e pasojave të mangësive dhe shkeljeve të konstatuara. Megjithatë, si rezultat i përmirësimit të cilësisë së punës dhe parandalimin e mospërsëritjes së shkeljeve dhe kthimin në fenomene negative në të ardhmen për subjektet e audituara, struktura e auditimit ka rekomanduar masa administrative, të cilat konsistojnë në:

-Arkëtimin e detyrimeve në arkën e shtetit në shumat e gjetura nga auditimi, dhe të pranuarat dëm ekonomik.

-Masa teknike dhe organizative në përmirësimin e punës në gjykatë.

-Në aspektin organizativ dhe prokurime publike.

-Në administrimin sa më të mirë ekonomik nga gjykatat, të aktiveve.

Masat administrative, i kemi lënë në autoritet të kryetarëve, mbi bazën e gjetjeve nga auditimi.

▪ **Propozimet për strukturën e rekomandimeve**

RAPORT VJETOR

Në ushtrimin e funksionit të tyre, Njësia Audituese, përqëndron një pjesë të madhe të përpjekjeve të saj, në dhënien e rekomandimeve për Kryetarët, të cilat synojnë përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe veprimtarisë së gjykatave për arritjen e objektivave. Për këtë qëllim, vlerësimi i sistemeve të MFK dhe veprimtarisë së gjykatave, shoqërohet me dhënien e rekomandimeve, të cilat duhet të jenë të sakta, realiste dhe të zbatueshme. Në përgjithësi, rekomandimet e dhëna gjatë vitit 2013, do të klasifikoheshin në grupet e mëposhtme:

1. Rekomandime që lidhen me *përmirësimin e proceseve të vendimmarrjes, të politikave dhe procedurave të hartimit të strategjive, si dhe përcaktimit të objektivave.*

Në gjykatat e audituara përmirësimi i strukturave vendimarrëse dhe veprimtarisë së tyre, riorganizimi, i cili mundëson ndarjen e detyrave (arka, magazinë, financë, punonjës me ndjekjen e taksave) dhe shpeshherë rishikimi i funksioneve të tyre dhe menaxhimit të lartë, hartimi i rregulloreve, ndjekjeve e shërbimeve gjyqësore, dhe ruajtjes së asetëve publike.

2. Rekomandime për përmirësimin e *proceseve të implementimit të politikave, kuadrit ligjor e procedural të brendshëm e të jashtëm*, që drejton veprimtarinë e gjykatave (vendosja e procedurave, rregullave të qarta për parandalimin e fenomeneve negative, verifikimeve, autorizimeve, ndarja e detyrave sipas funksioneve dhe roleve të çdo zyrtari dhe masa antikorrupsion).

3. Rekomandime për përmirësimin e *sistemit të menaxhimit financiar*, me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, ekonomi dhe efikasitet i fondeve publike (rritja e cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit, vendosja e rregullave të kujdesshme për parandalimin e mashtrimit dhe vjedhjes, ruajtjen e asetëve etj.);

4. Rekomandime për *zhvillimin profesional të punonjësve* në subjektet publike dhe sidomos stafit që punon në strukturat e menaxhimit financiar.

5. Rekomandime për *ngritjen dhe zhvillimin profesional të kapaciteteve kontrolluese në gjykatë*(gjykatat e mëdha).

▪ **Përgjigjia dhe reagimet e menaxhimit në Gjykata**

Sikurse përcaktohet dhe në misionin e auditimit të brendshëm, objektivi strategjik i tij është *dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit dhe shtimin e vlerës së subjektit* nga kryetarët e gjykatave. Arritja e këtij objektivi, përcaktohet në një masë të madhe nga cilësia dhe zbatueshmëria e rekomandimeve, por tregon gjithashtu përgjegjësinë e auditimit për të gjetur rrugët më efektive për ndërgjegjësimin e menaxhimit të subjekteve publike mbi vlerën dhe përfitimet nga zbatim i rekomandimeve. Është e njohur, që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve, rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër, përgjegjësia e auditimit të brendshëm, nuk kufizohet vetëm në dhënien, por edhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, pasi dhe rezultatet e punës audituese, varen në një masë të madhe nga ky faktor. Nëse auditimi i brendshëm do të luajë një rol pozitiv, i

RAPORT VJETOR

cili do të konsistonte thjesht në dhënien e rekomandimeve, që jo rrallë rezultojnë të paqarta dhe të paaplikueshme, atëherë nuk do të bëhej fjalë për përmbushje të misionit dhe objektivave të tij strategjike, pra për vlerë të shtuar të subjektit të audituar apo përmirësim të veprimitarisë së gjykatës.

Rezulton se për vitin 2013, nga 14 gjykata të auditura, është konfirmuar zbatimi i rekomandimeve për 9 gjykata dhe 5 janë në afatin ligjor të raportimit. Ky tregues, përbën dhe vlerësimin që i bëhet punës audituese.

VI. Analiza e kapaciteteve të strukturave audituese

▪ Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB.

Fuqizimi i strukturës dhe me një audit, besoj është dhe një zgjidhje më e mirë për rritjen e cilësisë së punës.

Ndonëse ndërmerren iniciativa të rëndësishme për të realizuar funksionimin normal të gjykatave, veprimtaria e tyre parashikohet të jetë e shoqëruar edhe me risqe të fushës gjatë aktivitetit. Në përmbushjen e objektivave dhe programit të saj, struktura e AB ka parë me interes dhe njohjen e risqeve, nga të cilat si më të mundshmit, vlerësohen të jenë: Niveli i kualifikimit, aftësitë profesionale të stafit të strukturës së AB.

Procedurat e domosdoshme për miratimin dhe hyrjen në fuqi të akteve ligjore e nënligjore (qarkullimi i dokumentacionit apo vonesat), të cilat kërkojnë kohë të konsiderueshme për ndjekje dhe zbatim. Burimet njerëzore dhe sigurimi i bazës së nevojshme me burime materiale dhe njerëzore për kryerjen normale të veprimitarisë.

▪ Kapacitete audituese

Sigurimi i cilësisë, i përcaktuar në standartin 1310 të IIA-së, përcakton detyrimin që:
”Drejtuuesi i njësisë së auditimit duhet të hartojë dhe të mbajë një program që të sigurojë cilësinë e auditimeve të kryera dhe të vlerësojë veprimet e njësisë së auditimit të brendshëm.”

Qëllimi i këtij programi është të krijojë një siguri të arsyeshme në përputhje me standardet dhe praktikat profesionale të auditimit të brendshëm, të kartës së auditimit e standardeve të tjera të aplikueshme. Pjesë e rëndësishme e sigurimit të cilësisë është mbikëqyrja dhe rishikimi i jashtëm i veprimitarisë së strukturave audituese. Përputhja me standardet e aplikueshme, shkon përtej pajtueshmërisë me politikën dhe procedurat e miratuara, pasi përfshin: vlerësimin e performancës së vetë njësisë së auditimit dhe nivelin e efektivitetit të saj.

Në ligjin e auditit përcaktohet qartë se, mbikëqyrja dhe vlerësimi i njësisë të auditimit të brendshëm, të ngritura pranë subjekteve publike, kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit dhe KLSH-ja. Ndërkohë, që vetë njësitë e audituara, kanë

RAPORT VJETOR

dhënë komente zyrtare mbi punën dhe cilësinë e NJAB-së me raportet përkatëse. Për vetë burimet në dispozicion, ne kemi bërë auditim të cilësisë për një pjesë të vitit 2014. Gjatë vitit 2015, do të vendosim standart kontrolli të cilësisë, me plotësimin e strukturës nga Bordi.

▪ Burimet e AB dhe cilësia.

Në realizimin e misioneve të parashikuara sa më sipër sistemi i auditimit, do të përdorë burimet njerëzore e materiale të vëna në dispozicion nga Zyra dhe Bordi. Çdo raport auditimi, është një produkt publik dhe si i tillë, duhet të çertifikohet. Për vetë strukturën e auditimit, ne nuk mund të realizojmë një kontroll të cilësisë. Per vitin 2015, do të kemi kontroll cilësie. Do të vijojme auditimin e përvitshem të organizuar nga Ministria e Financave.

VII. Konkluzione

▪ Konkluzione mbi problematikën e punës audituese

Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive, i konceptuar për të shtuar vlerën e subjektit publik të gjykatave. Ai mbështet menaxhimin, duke dhënë siguri, që kontrollet janë ngritur në pajtueshmëri me rregullat dhe standardet dhe sipas parimeve të shëndosha të menaxhimit financiar, dhe njëkohësisht ofron rekomandime për përmirësimin dhe funksionimin efikas të këtyre kontrolleve.

Si një nga tre “shtyllat” e sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, funksioni i auditimit zhvillohet dhe përmirësohet në vazhdimësi, në mënyrë që të fitojë rolin e tij të ri modern, si vlerësues dhe këshillues për sistemet dhe të sigurojë arritjen e objektivit të tij strategjik, gjithnjë në pajtueshmëri me standardet dhe praktikat më të mira.

Në këtë këndvështrim, qëndrimi ynë, është dhe do të jetë gjithnjë kritik kundrejt problemeve dhe risqeve që ndikojnë në përmbushjen e misionit për një qeverisje të mirë në gjyqësor, duke shprehur bindjen se sot, gjyqësori është pararojë e menxhimit të mirë dhe të shëndoshë në astetet publike dhe parane publike në R.SH.

▪ Prioritetet për vitin e ardhshëm

- ◆ Zhvillimi i kapacitetit institucional të NJAB;
- ◆ Përmirësimi i kapaciteteve audituese dhe cilësisë së auditimit;
- ◆ Rritja e numrit dhe cilësisë së auditimit të performancës;
- ◆ Përgatitja dhe konsolidimi i auditimeve të teknologjisë së informacionit;
- ◆ Rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit në procesin e auditimit;

RAPORT VJETOR

- ◆ Forcimi i rolit të NJAB-së kundër korrupsionit, dhe bashkëpunimit me KLSH dhe NjQH;
- ◆ Zhvillimi i bashkëpunimit me aktorë të tjerë përkatës brenda vendit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Drejtuesi i Njesisë së Auditimit

Artur MAMADHAJ